



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.728/2017

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si kontestimore e përberë nga Gjyqtari individual Naim Mehulli, ne çështjen juridike te paditëses nga Mitrovica te cilin e përfaqëson Av. nga kundër te paditurës Komuna e , për shkak te kompensimit te ardhurave ne emër te shpërblimit jubilar dhe kompensimin te pagave përcjellëse për ne pension pas mbajtjes se seancës kryesore me dt.07.11.2018 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESERISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësit nga Mitrovica dhe,

II.OBLIGOHET e paditura Komuna e Mitrovicës t'ia paguajë paditësit ne emër te pagesës për shpërblim jubilar pas pensionimit si mësimdhënës te e paditura për 40 vjet te provojës se punës ne vlerë te 150% te një page bazë, shumen prej **685 euro**, dhe ne emër te 3 pagave përcjellëse për ne pension, shumen prej **1371 euro**, respektivisht shuma totale prej **2056 euro (dy mije e pesëdhjetë e gjashtë euro)**, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit ligjor.

III.OBLIGOHET e paditura t'ia paguajnë paditëses shpenzimet e procedurës në shumë prej **259 euro**, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit ligjor.

IV.REFUZOHET E PA BAZUAR pjesa e kërkesëpadisë së paditëses Halide Jashari nga Mitrovica, për kompensimin e një page e gjysmë për shpërblim jubilar ne shumën prej 685 euro.

A r s y e t i m

Paditësja përmes te autorizuarit te saj me datën 04.12.2017 ka ushtruar padi për kompensimin e te ardhurave personale pas pensionimit dhe atë ne emër te tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe 3 për shpërblimin jubilar ne shumën e përgjithshme prej 2744.16euro.

Gjykata, me dt. 05.11.2018, ka caktuar seancë për shqyrtim përgatitore, ne te cilën ka prezantuar e autorizuara e paditëses, dhe i autorizuarit i te paditurës.

E autorizuar e paditëses në seancë dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se mbetem pranë padisë dhe kërkesë padisë që e njëjta të aprovohet e paraqitur me datë 04.12.2017 me anë të se cilës kemi kërkuar njohjen apo kompensimin e pagave përcjellëse dhe jubilarë 2744.16 euro, duke u bazuar në kontratën kolektive parauniversitare përkatësisht nëni 36 paragrafi 9 dhe 10 ku theksohet se përfundon kur punonjësit e arsimit të cilët dalin në pension dhe të cilët i plotësojnë kushtet për pension iu takon shpërblimi jubilar prej tri pagave dhe tri pagave përcjellëse, paditësja Halide Jashari me daljen në pension me datë 19.05.2017 i ka plotësuar kushtet për këtë kompensim. I propozoj gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovoj në tersi si të bazuar si dhe ti aprovoj shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë në emër të taksës gjyqësore 20 euro, për përpilimin e padis 104 euro si dhe në emër të përfaqësimit për seance 135 euro, gjithsej në emër të shpenzimeve shumën prej 259 euro, heqim dorë nga kamata ligjore.

I autorizuari i të paditurës në seancë dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se e kundërshtoj padinë dhe kërkesëpadinë duke theksuar që paditësja në pension ka dalur në pension me datë 19.05.2017 andaj kompensimin për pagesën jubilarë duhet të bëhet sipas kontratës kolektive të nënshkruar ndaras për sistemin Arsimor të Kosovës me datë 17.04.2017. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkoj.

Gjykata, në procedurën e leximit të provave, referuar nenit 7 dhe 8, lexoi: Kopja e letërnjoftimit për paditësen, kërkesa e paditëses drejtuar të paditurës për kompensimin e pagave përcjellëse dhe jubilarë të datës 11.07.2017, vendimi për pushimin e marrëdhënies së punës lëshuar nga e paditura me nr. _____ i datës 05.05.2017, vërtetimi lëshuar nga shkolla SHFMU "Xhevat Jusufi" me numër 12/2016 i datës 25.03.2016, pasqyra e llogaris bankare të paditëses i datës 02.06.2017, njoftimi i lëshuar nga komuna e Mitrovicës i datës 14.08.2017, vërtetimi i lëshuar nga SHFMU "Trepça" në Stanterg me nr. _____ i datës 14.03.2017.

Nuk është kontestues fakti që paditësja ka qene në marrëdhënie pune të e paditura si mësimdhënëse për më tepër se 40 vite, ky fakt u vërtetua nga vërtetimet nga Shkollat SHFMU "Xhevat Jusufi" dt.25.03.2016 dhe Shkolla SHFMU "Trepça" 14.03.2017.

Nuk është kontestues fakti se lartësia e pagës neto që paditësja e ka realizuar nga e paditura para pensionimit është shuma mujore prej 457 euro, ku kjo vërtetohet nga gjendja e llogarisë e datës 02.06.2017 për periudhën 01.12.2016 deri me 02.06.2017.

Nuk është kontestues se paditëses i ka pushuar marrëdhëniet e punës për shkak të plotësimi të kushteve për pension të pleqërisë, e kjo vërtetohet nga vendimi nr. _____ i dt. 05.05.2017.

Nuk është kontestuese se paditësja ka paraqit kërkesë tek e paditura sa i parkete realizimit të kësaj kërkesë lëndore, kjo vërtetohet në baze të kërkesës së paditëses, e të

cilen kërkesë e paditura e ka pranuar me dt.18.07.2017, e për te cilin kërkesë ne bazë te shkresave te lendes e paditura me date 14.08.2017 i eshët përgjigjur dhe e ka njoftuar te njëjtën se DKA nuk gjeti baze qe te ua kompensoj pagat e kërkuara pas pensionit dhe njoftoi se me Ligjin e punës nuk janë paraparë kompensime te tilla.

Gjykata, lidhur me bazën e kërkesë padisë, iu referua nenit 35 par. 8 nën par 8.4 të Kontratës Kolektive të Arsimit te dt.18.04.2017 e cila parasheh se "punëtorët të cilët dalin në pension përfitojnë shpërblim jubilar për 40 vjet të përvojës në vlerë të 150% të një page bazë" dhe nenit 35.9 të po të njëjtës kontratë i cili parasheh se "punëtorët të cilët dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri (3) pagave, sipas mesatares se tri pagave të fundit të punëtorit".

Gjykata, lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë, u referua në vlerën e tri pagave të fundit të paditësit e cila vërtetohet në bazë të pasqyrës bankare të dt. 18.05.2018, se paditësi ka marre tri pagat e fundit ne vlere prej 467.70 euro si dhe nenit 35 par. 8 nënpar. 8.4, dhe nenit 35 par 9, të Kontratës Kolektive të Arsimit të dt.18.04.2017.

Prandaj, gjykata bazuar ne nenit 35 par. 8 nënpar. 8.4 dhe nenit 35 par 9 të Kontratës Kolektive të Arsimit të dt.18.04.2017 vendosi për kompensimin e shumës së përgjithshme prej **2056 euro (dy mije e pesëdhjetë e gjashtë euro)**, dhe atë në emër të tri pagave përcjellëse shumë prej 1371 euro dhe në emër të shpërblimit jubilar (150% një page bazë) shumë prej 685 euro.

Gjykata lidhur me kërkesën për kamatën ka vendosur ne kuptim te nenit 294 lidhur me nenin 378 të LMD-se.

Sa i përket pjesës refuzuese të kërkesëpadisë, gjykata nuk e aprovoi në lartësinë e cekur si ne kërkesëpadi nga ana e te autorizuarës se paditëses, pasi qe Gjykata lidhur me vendosjen u bazua në Kontratës Kolektive te Arsimit të Kosovës nr.0113/2056, pasi që e njëjta është nënshkruar dhe ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe e rregullon këtë çështje në mënyrë specifike dhe se paditësja ne pension ka dalur (19.05.2017) ne kohen kur ka hy ne fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë nr.0113/2056 datës 18.04.2017, ndërsa sa i përket bazës në Kontratën Kolektive e Arsimit Parauniversitar 01B 2200 te datës 11.04.2014, me te cilën parashihet se "punëmarrësi i cili për 30 vjet radhazi dhe pandërprerë te përvojës se punës te punëdhënësi i fundit ti njihet e drejta ne shpërblim jubilar ne lartësia te tri pagave mujore te tij" gjykata nuk mund ta merr për bazë këtë Kontratë për faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë nr.0113/2056 datës 18.04.2017 e ka shfuqizuar Kontratën Kolektive te Arsimit Parauniversitar 01B 2200 te datës 11.04.2014, konkretisht neni 48 i Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë nr.0113/2056 datës 18.04.2017 ku eshët parapa se me hyrjen ne fuqi te kësaj Kontrate shfuqizohet Kontratën Kolektive te Arsimit Parauniversitar 01B 2200 te datës 11.04.2014.


Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën

Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve të përfaqësuesit të autorizuar të paditëses, për 1 seancë të mbajtur, në shumën prej 135 euro, 104 euro ne emër te përpilimit te padis dhe 20 euro ne emër te taksës për padi.

Gjykata aktgjykimin e saj e bazoi në nenin 143 par 1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.728/2017 data 07.11.2018

GJYQTARI
Naim Mehulli



UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj Gjykate.